L I G J
Nr.8484, datë 10.5.1999

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7761, DATË 19.10.1993 "PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse", në nenin 23 pas shkronjës "c" shtohen shkronjat "ç" dhe "d" me këtë përmbajtje:

"ç) Ndryshimet e skemës së vaksinimit (në kalendarin e detyrueshëm të vaksinimit), të përcaktuara në shkronjën "c", bëhen nga Ministria e Shëndetësisë, sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

d) Ministria e Shëndetësisë propozon dhe miraton aktet nënligjore përkatëse për kontrollin, kushtet teknike dhe llojet e vaksinave që mund të importohen dhe mund të tregtohen privatisht, jashtë kalendarit të vaksinimit."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2373, datë 20.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani